

NJË MODEL PËR LIDERSHIP TË IMAMIT DHE PËR MATJEN E PERFORMANCËS SË XHAMISË

(MODEL MALAJZIAN)

Abstrakt

Ky punim synon të trajtojë tre argumente kryesore.

E para, performanca e xhamisë mund të matet të paktën duke përdorur dy dimensione; numri i xhematit të rregullt të xhamisë dhe numri i ligjëratave fetare të organizuara nga xhamia.

E dyta, parashikimi i performancës së xhamive duke bërë lidhshmërinë e kapaciteteve udhëheqëse të imamëve dhe performancës së xhamive, kjo duke u bazuar në supozimin se tiparet e lidershipit të imamëve dhe aftësitë dhe sjellje efektive e tyre kanë një rol në udhëheqjen e xhamive.

E treta, lidhja e tipareve të udhëheqjes së imamëve, sjelljes së lidershipit dhe performancës së xhamisë mund të moderohet nga niveli i autonomisë që kanë imamët. Ky studim aplikon qasjen e analizës së përmbajtjes për të analizuar hulumtimet dhe teoritë në fushën e studimit të udhëheqjes organizative si dhe performancën e xhamisë. Bazuar në analizën e kryer, ky studim propozon një model të lidhjes ndërmjet lidershipit të imamëve dhe performancës së xhamisë që do të zbatohet në kërkimet në lidhje me udhëheqjen e imamëve dhe performancën e xhamive në Malajzi apo kudo tjetër.

Fjalë kyçe: **Sjellja e lidershipit; Imamët; Performanca e xhamisë**

HYRJA

Ky artikull synon të diskutojë çështjen e udhëheqjes së imamëve në Malajzi bazuar në faktorin që grupi i liderëve (imamëve) u tërhoq kohët e fundit në çështjen e menaxhimit dhe performancës së xhamive në vend. Si përgjigje ndaj çështjes, ky artikull zbuloi se ka të paktën dy kritika të paraqitura nga akademikë muslimanë dhe zyrtarë qeveritarë në Malajzi. Një aspekt i kritikave për çështjen e imamëve duhet të vlerësohet me përgjegjësi dhe autonomi më të madhe si drejtues të xhamive, në mënyrë që të mundësohet funksionimi optimal i tyre. Një aspekt tjetër i kritikave vuri në dukje disa cilësi të rëndësishme individuale që imamët duhet të zotërojnë për të rritur performancën e tyre. Në lidhje me këtë çështje, janë të paktën dy cilësi individuale që imamët duhet t'i kenë. Së pari, imamët dhe zyrtarët e tjerë të xhamive duhet të kenë njohuri udhëheqëse dhe menaxhuese dhe jo vetëm njohuri fetare. Së dyti, imamët dhe zyrtarët e xhamive duhet gjithashtu të kenë personalitete të mira dhe shembullore që janë të përshtatshme me pozitën fetare që ata mbajnë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se kritikrat ndaj udhëheqjes dhe performancës së imamëve bazoheshin kryesisht në disa vëzhgime të përgjithshme që zbuluan xhamitë në Malajzi, ku funksionojnë imamët, nuk vizitohen shpesh nga muslimanët përreth institucionit, veçanërisht për të kryer namazet me xhematë. Ndoshta, dikush mund të argumentojë se kritika për udhëheqjen e xhamisë ishte shumë e nxituar ose e bërë shpejt. Kjo ndodh sepse, ka shumë faktorë që kanë rezultuar në shfaqjen e këtij problemi, për

shembull ndryshimet në stilin e jetesës së muslimanëve të Malajzisë, kushtet e punës, rritja e numrit të mesxhideve, e kështu me radhë.

Pavarësisht nga faktorët që mund të kontribuojnë në problemin e shkallës së ulët të frekuentimit të xhamive në Malajzi, kjo analizë, në kapacitetin e saj të kufizuar, u përpoq ta eksplorojë çështjen nga këndvështrimi i fushës së studimit të udhëheqjes. Subjekti i këtij studimi ose imamët, nuk duhet të konsiderohen si kontribuuesi i vetëm në problemin, por, bazuar në hulumtimet dhe analizat e mëparshme të bëra mbi to ne mund të kuptojmë se imamët janë të rëndësishëm për organizimin e xhamive dhe komunitetin musliman në Malajzi apo kudo tjetër. Prandaj, bazuar në këtë faktor, duket se është e justifikueshme që ky artikull të analizojë udhëheqjen e imamëve në Malajzi si dhe rezultatet e tij në lidhje me performancën e xhamive në vend. Pritet që ky studim të ketë të paktën dy kontribute të mëdha. Së pari, ky studim mund të sigurojë disa informacione se si teoritë dhe gjetjet e lidhshëm mund të zbatohen për të rritur efektivitetin e udhëheqjes së xhamive në Malajzi. Së dyti, ky studim mund të sigurojë disa informacione se si subjektet apo praktikat e udhëheqjes së imamëve mund të na bëjnë të kuptojmë më tej dukuritë e udhëheqjes fetare dhe të komunitetit.

- **Rishikimi i teorive dhe hulumtimeve: Udhëheqja e Imamit dhe performanca e Xhamisë**

Korniza ose modeli teorik i propozuar nga ky artikull mund të shihet në figurën 1 (e cila gjendet në fund të këtij artikulli). Siç u shpjegua më lart, në përgjithësi, kjo analizë synon të eksplorojë udhëheqjen nga të paktën tre drejtime. Së pari, kjo analizë synon të eksplorojë lidhjen e sjelljes së udhëheqjes së imamëve dhe performancës së xhamisë. Së dyti, kjo analizë synon të eksplorojë lidhjen e tipareve të lidershit dhe sjelljes së imamëve. Së treti, kjo analizë eksploron gjithashtu autonominë e punës së imamëve si një moderator potencial për tiparet e udhëheqjes, sjelljen dhe lidhjen e performancës së imamëve të xhamisë.

- **Sjellja e imamit si prijës komunitar dhe performanca e xhamisë**

Studiuesit muslimanë në Malajzi theksuan se performanca e institucionit të xhamisë mund të matet nga shumë aspekte, për shembull, numri i xhematit të cilët vizitojnë rregullisht institucionin, aktivitetet e organizuara nga xhamia, stabiliteti financiar. Megjithatë, ndër të gjitha kriteret e performancës së xhamisë, frekuentimi i saj mund të përmendet si kriteri më i rëndësishëm.

Politeistëve, idhujtarëve e paganëve nuk u takon të mirëmbajnë xhamitë e Allahut (të falen dhe të adhurojnë Allahun në to, të kujdesen për pastërtinë dhe ndërtimin e tyre).

“Xhamitë e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.” (Et-Teube:18).

“ Faleni namazin, jepeni zekatin dhe përkuluni në ruku bashkë me ata që përkulen (në namaz).” (El-Bekare: 43)

Sipas Kurtubiut, ajeti 43 i sures el-Bekare më sipër theksoi se muslimanët nuk duhet të jenë kurrë në të njëjtë kategori me Pasuesit e Librit në lidhje me namazin, ku mësimet e Muhamedit alejhi selam në lidhje me namazin theksojnë cilësitë e robit, qetësinë e tij, dhe përkushtimin të cilat mbartin kuptimin e vërtetë të bindjes ose adhurimit ndaj Allahut të Madhërishëm si Krijuesi ose Zoti i Vetëm. Për më tepër, namazet obligative duhet të falen gjithmonë në xhemat dhe jo vetëm, përveç nëse muslimanët kanë arsye të vlefshme që të mos e falin namazin me xhemat për shembull për shkak të sëmundjes e kështu me radhë. Kështu, duke iu referuar ajeteve të mësipërme, praktika e faljes së namazit me xhemat në xhami nuk duhet të konsiderohet si bartëse e roleve minimale për të na ndihmuar të matim cilësinë e komunitetit musliman në ditët e sotme.

Përveç asaj që u tha më sipër, në Islam është e qartë se caktimi i vizitës së xhamive, veçanërisht për kryerjen e namazit të

detyrueshëm me xhemat është i rëndësishëm dhe mund të thuhet se është prej çështjeve themelore që ndihmon në shtimin e devotshmërisë, besimit dhe bindjes ndaj Allahut. Me fjalë tjera, përkundër shpërblimeve të premtuara nga Allahu i Madhërishëm për ata që e ruajnë lidhjen e tyre me shtëpinë e Allahut (xhamitë), ka edhe dënime të premtuara nga Allahu për ata që shpërfillin thirrjet për namazet me xhemat ose ezanin. El-Xhezeri ka arritur në përfundim se sipas katër medhhebeve kryesore, thirrja për faljen e pesë kohëve të namazit me xhemat në xhami nesë jo obligim i prerë mund të llogaritet prej suneteve të forta (veprime shumë të rekomanduara të cilat rrallë herë i ka lënë i Dërguari i Allahut) për të cilat ka urdhëruar Muhamedi alejhi selam. Kjo tregon se edhe pse kryerja e namazeve obligative në formë individuale është e vlefshme dhe e pranueshme në fenë tone, rutinën ditore duhet ta ndërtojme në pëputhje me aktivitetet e xhamisë e me theks të veçantë namazin me xhematë.

Prandaj, bazuar në diskutimet e mësipërme lidhur me pozitën e namazit me xhemat në Islam, nuk është ekgzagjerim nëse ndonjë hulumtim socio-fetar që fokusohet në eksplorimin e qëndrimit të muslimanëve ndaj fesë së tyre, të përdoret frekuentimi i xhamisë në namazet me xhemat dhe aktivitetet tjera brenda xhamisë, si masë e qëndrimit të muslimanëve ndaj fesë së tyre. Në fakt, Brenner ka gjetur se frekuentimi i vendeve të shenjta dhe në rastin e tij kishave është një mates i mirë dhe i vërtetuar për shkallën e fetarisë së individit. Në hulumtim, pas krahasimit të dy matjeve të fesë; së pari raportoi i drejtpërdrejt për

pjesëmarrjen në organizimet fetare e cila shpesh llogaritet si masë paragjyquese, dhe së dyti, matjet e vërtetuara dhe të detajuara të fesë, Brenner arriti në përfundimin se “të dy grupet e konsiderojnë fenë dhe identitetin e tyre fetar si të rëndësishëm në jetën e tyre”. E njëjta gjë mund të themi se ekziston edhe në shoqërinë muslimane dhe ky argument duhet të interpretohet me kujdes për shkak të dallimeve themelore teologjike dhe fetare midis Islamit dhe Krishterimit. Kjo mund të shihet edhe nga një hulumtim i kryer nga Neyrinck që zbuloi se motivimi fetar lidhet pozitivisht vetëm me angazhimin në sjellje specifike fetare, por jo me pjesëmarrjen e shpeshtë në kisha. Kjo në njëfarë mënyre tregon dallimet ndërmjet Islamit dhe Krishterimit nëse i referohemi ajeteve kuranore dhe haditheve në lidhje me urdhërimin e Allahut dhe të Profetit të Tij që muslimanët të falin namazin me xhemat në xhami. Megjithatë, ky artikull përpiket të argumentojë se instrumenti i përdorur nga Brenner për të vlerësuar fenë e dikujt mund të zbatohet në kontekstin islam. Kjo për shkak se, siç u shpjegua më lart, bazuar në ajetet kuranore dhe hadithet e profetit Muhamed, frekuentimi i shpeshtë në xhami është tregues i devotshmërisë dhe lidhjes së dikujt me fenë islame. Edhe pse, ky argument mund të thuhet se është po aq i thjeshtë, për shkak të faktorit që ne nuk marrim detaje specifike në lidhje me ndjenjat fetare të dikujt që lidhen me devotshmërinë kur një musliman shkon në xhami (veçanërisht për të kryer namazet me xhemat), ky matës të paktën mund të shpjegojë sjelljen e besimtarëve bazuar në Kuranin dhe hadithet e Profetit. Megjithatë, ky artikull sugjeron

që pyetja se sa frekuentimi i shpeshtë në xhami mund të kontribuojë në zhvillimin e devotshmërisë së muslimanëve, siç shpjegohet në Kuran dhe hadithe, të hulumtohet më tej duke përdorur qasje të shumta kërkimore.


Prandaj, studiuesit janë të justifikuar të argumentojnë se xhamitë në Malajzi nuk po funksionojnë siç duhet bazuar në numrin e ulët të muslimanëve që vizitojnë rregullisht xhamitë për faljen e namazeve me xhemat. Për më tepër, bazuar në disa vëzhgime në Kuala Lumpur, kuptohet se xhamitë në kryeqytetin e Malajzisë organizonin shpesh programe të ndryshme fetare dhe kjo ka rezultuar në një rritje të frekuentimit të xhamive. Enuerulhak arriti në përfundim se xhematet e muslimanëve në xhamitë e Malajzisë dhanë reagime pozitive ndaj aktiviteteve fetare të organizuara nga xhamitë. Kjo tregon se, në bazë të hulumtimeve, organizimi i ligjëratave të ndryshme fetare dhe aktiviteteve të tjera në xhami janë të rëndësishme dhe të mirëpritura nga komuniteti musliman. Prandaj, bazuar në këto hulumtime, studiuesit thonë se përveç personalitetit të fortë dhe njohurive fetare, imamët duhet të jenë gjendje të menaxhojnë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme fetare për të tërhequr më shumë njerëz drejt xhamisë. Si përmbledhje, bazuar në argumentet e mësipërme, ky artikull propozon që imamët në Malajzi dhe ndoshta në vendet tjera duhet të praktikojnë listën e sjelljeve që janë parë si të rëndësishme për udhëheqësit organizativë. Hulumtimet në lidhje me ndikimin pozitiv të sjelljes efektive të lidhshpimit ndaj performancës organizative janë të shumta. Megjithatë, përveç ndikimit të sjelljes efektive të

lidershipit ndaj performancës së xhamisë, ky artikull gjithashtu thotë se sjellja udhëheqëse e imamëve ndërmjetëson ndikimin e tipareve drejtuese të imamëve ose aftësisë së përgjithshme njohëse, personalitetit, fetarisë, përvojave të kaluara të lidershipit dhe motivimit për të udhëhequr drejt performancës sa më të mirë të xhamisë.

- **Tiparet dhe sjellja e lidershipit**

Disa studiues të lidershipit këmbëngulin që studimi i lidershipit nuk duhet të ndahet nga studimi i karakteristikave të liderëve. Edhe pse, perspektivat e tipareve të liderit dikur konsideroheshin si të pamjaftueshme për të shpjeguar fenomenet e lidershipit efektiv për shkak të rishikimit pesimist të Stogdil dhe Mann, Zaccaro theksoi se çështja nuk duhet të zvarritet deri në fundin e kërkimit të tipareve të lidershipit. Kjo është për shkak se studiuesit e tipareve të lidershipit zbuluan se gjetjet e tipareve të lidershipit janë ende të rëndësishme për të na dhënë informacion në lidhje me lidershipin efektiv nëse hulumtimet e tipareve janë të integruara me variabla të tjerë të rëndësishëm të lidershipit, për shembull, performancën dhe situatat e lidershipit. Për më tepër, House, Aditya si dhe Zaccaro kanë përmbledhur listën e tipareve të liderëve që janë gjetur si të rëndësishme në shumicën e hulumtimeve të mëparshme të lidershipit. Bazuar në përmbledhjet e ofruara nga studiuesit, hulumtimet e fundit të kryera në fushën e tipareve të lidershipit, si dhe argumentet në lidhje me tiparet e përshtatshme të

imamëve, ky hulumtim nxori në pah disa tipare lidershipi që imamët në Malajzi duhet të kenë. Tiparet e lidershipit janë:

- Aftësia e përgjithshme njohëse,
- Personaliteti,
- Feja,
- Motivi për të udhëhequr dhe  Përvojat e kaluara në lidership.

Aftësia e përgjithshme njohëse dhe sjellja e lidershipit

Studiuesit e lidershipit kanë gjetur se konstruktet e ndryshme njohëse janë të mundshme për të ndikuar në performancën e lidershipit. Në përgjithësi, ekzistojnë tre fusha të përbashkëta të aftësisë njohëse që janë gjetur si paraardhës të rëndësishëm të lidershipit. Tri fushat e aftësisë njohëse janë:

- (1)** aftësia e përgjithshme njohëse;
- (2)** aftësitë e të menduarit krijues;
- (3)** aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse.

Përveç sa më sipër, një aspekt tjetër i aftësisë njohëse që është gjetur si i rëndësishëm për të parashikuar lidershipin, veçanërisht vetë-efikasitetin e lidershipit dhe orientimin e qëllimit, është aftësia analitike. Për më tepër, në një hulumtim tjetër, kreativiteti është gjetur i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me lidershipin inovativ. Një aspekt i aftësisë

njohëse që duhet të fokusohet është aftësia e përgjithshme njohëse. Aftësia e përgjithshme njohëse u gjet si një nga parashikuesit e lidërshiptit në disa kërkime të mëparshme. Edhe pse studiuesit kanë deklaruar se inteligjenca e përgjithshme dhe variablat kognitive parashikojnë vazhdimisht lidërshiptin, ka pasur disa kërkime që zbuluan se variablat kognitive kanë ndikim minimal deri të moderuar ndaj lidërshiptit. Përveç kësaj, ka pasur edhe disa kërkime që zbuluan se cilësi të tjera individuale, për shembull, aftësitë e lidërshiptit, personaliteti dhe motivimi ndikuan në lidërshipt më shumë sesa variablat kognitive. Kjo duket se tregon se ndikimi i variablave njohës ndaj lidërshiptit është i paqëndrueshëm dhe jopërfundimtar. Megjithatë, bazuar në rishikimet e bëra nga studiuesit, ky artikull arrin në përfundimin se variabla kognitive qëndron si një nga parashikuesit e udhëheqjes së imamëve. Hipoteza mbështetet nga Rogers i cili zbuloi se imamët duhet të kenë arsimim të mjaftueshëm. Gjetja mund të thuhet se është në përputhje me disa kritika të bëra nga Wan Mohamad, dhe Abdullah. Për më tepër, Chan argumentoi se niveli i arsimimit mund të përdoret si një masë e shqetësimit të përgjithshëm njohës të individëve.

- **Personaliteti dhe sjellja e lidërshiptit**

Në teorinë e modelit të pesë faktorëve të personalitetit, personaliteti përbëhet nga pesë kategori të gjera dhe komplekse të tipareve njerëzore. Pesë kategoritë e tipareve janë:

(1) Neuroticizmi (ose stabiliteti emocional);

(2) Ekstraversioni;

(3) Hapja ndaj përvojës;

(4) Pajtueshmëria;

(5) Ndërgjegjshmëria.

Në përgjithësi, studiuesit e lidërshiptit zbuluan se dimensionet e 'Modelit Pesë Faktorësh' të personalitetit kanë ndikuar në sjelljen e lidërshiptit. Bazuar në këtë faktor, personaliteti ka qenë një nga faktorët më të zakonshëm që përdoret nga studiuesit për të matur lidërshiptin. Ka disa arsye për adoptimin e shkallës së personalitetit në studimet e lidërshiptit. **Së pari**, sjellja është një funksion i personalitetit. **Së dyti**, personaliteti ka një natyrë të ngjashme me tiparet, që do të thotë se personaliteti është i qëndrueshëm përgjatë moshës madhore dhe ka fuqi parashikuese. **Së treti**, përgjatë historisë së kërkimeve rreth lidërshiptit, personaliteti nuk është lënë pas dore kurrë nga studiuesit. Në fakt, studimet e mëparshme të lidërshiptit u përqendruan në marrëdhëniet midis tipareve dhe lidërshiptit. Këto tre pika sugjerojnë që personaliteti nuk duhet të neglizhohet nga studiuesit e lidërshiptit. Kjo mund të shihet nga kërkime të shumta që hetuan lidhjen e personalitetit dhe lidërshiptit. Kjo ka bërë që kjo analizë të përzgjedhë personalitetin e imamëve si një nga variablat që mund të parashikojë sjelljen e tyre udhëheqëse. Mund të themi se ky argument është në përputhje me debatin e ngritur nga Wan

Muhamed, i cili ishte kritik ndaj imamëve në Malajzi duke i këshilluar ata se duhet të merren me personalitetin e tyre.

- **Feja dhe sjellja e lidershipit**

Siç argumentohet nga disa studiues, imamët në Malajzi për të arritur ndikim tek masa dhe për të qenë lider shembull duhet të jenë fetarë. Ky argument është në përputhje me pritjet e përgjithshme të popullsisë muslimane në Malajzi, të cilët i konsiderojnë imamët e tyre si udhëheqës fetarë të komunitetit. Për më tepër, religjioziteti është gjetur si një parashikues i rëndësishëm i sjelljes së lidershipit në organizatat fetare të krishtera. Përveç kërkimeve, Jouili dhe Amir-Moazami gjetën se praktikat edukative fetare kanë bërë që gratë muslimane në Francë dhe Gjermani të fuqizohen me përgjegjësinë e udhëheqjes fetare. Kështu, bazuar në hulumtimet, ky artikull supozoi se dimensionet e fesë islame kanë disa ndikime në sjelljen udhëheqëse të imamëve. Për më tepër, ky studim synonte të rriste të kuptuarit tonë mbi ndikimin e fesë në sjelljen e lidershipit. Kjo bazohet në arsyen që ky studim hulumtoi ndikimin e fesë së bashku me tiparet e tjera të lidershipit (aftësia e përgjithshme njohëse, personaliteti, përvojat e kaluara të lidershipit) ndaj sjelljes udhëheqëse të imamëve. Hulumtimet e mëparshme hetuan vetëm marrëdhënien e dyanshme të fesë dhe lidershipit pa përfshirë disa parashikues të tjerë.

- **Përvojat e kaluara të lidërshiptit dhe sjellja e lidërshiptit**

Llojet specifike të përvojave të liderit u zbuluan se lidhen me indekse të ndryshëm të performancës së liderit. Një hulumtim i kohëve të fundit që hetoi marrëdhënien e përvojave të kaluara të lidërshiptit si një paraardhës ndërmjetësues për sjelljen e lidërshiptit është ai i bërë nga Iddekinge. Në lidhje me përvojat e kaluara të lidërshiptit, Iddekinge gjeti se përvojat e lidërshiptit parashikonin ndjeshëm njohuritë, mundësitë dhe aftësitë e liderëve në parashikimin e performancës së lidërshiptit. Më herët se Iddekinge, Chan zbuloi se përvojat e kaluara të lidërshiptit dhe vetë-efikasiteti i lidërshiptit ndërmjetësuan lidhjen e paraardhësve distalë (aftësia e përgjithshme njohëse, personaliteti dhe vlerat) me motivin për të udhëhequr në parashikimin e potencialit të lidërshiptit. E njëjta gjë u gjet edhe nga Chan dhe Drasgow në hulumtimin e tyre të sjelljes së lidërshiptit. Kështu, bazuar në këto hulumtime, ne mund të themi se përvojat e kaluara të lidërshiptit ishin më afër potencialit dhe sjelljes së lidërshiptit. Prandaj, në përmbledhje, bazuar në hulumtimet e mëparshme, ky studim supozoi se përvojat e kaluara të lidërshiptit funksionojnë si një përfrim i lidhjes së aftësisë së përgjithshme njohëse, personalitetit dhe fesë me sjelljen e lidërshiptit. Në lidhje me një variabël tjetër të largët ose fetarinë, edhe pse nuk kishte hulumtime për lidhjen e fesë dhe përvojave të kaluara të lidërshiptit në parashikimin e sjelljes së lidërshiptit, ne mund të shihnim qëndrimin e fesë si një nga variablat e tipareve distale bazuar në lidhjen e fortë të fesë dhe personalitetit të cilat janë gjetur në kërkimet e mëparshme. Për

më tepër, fetaria mund të grupohet nën kategorinë e vlerës së lidershipit, e cila është një nga tiparet distale të liderëve siç teorizohet nga studiuesit e lidershipit.

- **Motivimi për të udhëhequr (MTL: Motivation to lead) dhe sjellja e lidershipit** Rogers zbuloi se imamët në Malajzi duhet të kenë njëfarë motivimi për të funksionuar si udhëheqës fetarë. Ky artikull ka ardhur në përfundim se një koncept specifik i motivimit të lidershipit i quajtur motivimi për të udhëhequr ose MTL (Motivation to lead – nga gjuha angleze, këtë shkurtesë do ta përdorim në vazhdim të këtij artikulli) mund të përdoret për të eksploruar motivimin e lidershipit të imamëve. Chan dhe Drasgow deklaruan se: “konstruktet e ndryshme jo-konjitive të aftësive si personaliteti dhe vlerat lidhen me sjelljet e liderit nëpërmjet motivimit të individit për të udhëhequr (MTL), i cili nga ana tjetër ndikon në pjesëmarrjen e individit në rolet dhe aktivitetet e lidershipit.”. Bazuar në përkufizimin, Chan dhe Drasgow kanë pohuar se MTL është një paraardhës i sjelljes së lidershipit dhe gjithashtu funksionon si ndërmjetës për tiparet e lidershipit dhe marrëdhëniet e sjelljes së lidershipit. Kjo është arsyeja pse ky artikull hipotezoi MTL si një ndërmjetës për ndikimin e tipareve të lidershipit në sjelljen e lidershipit. Për më tepër, studiues të tjerë gjithashtu argumentuan të njëjtën gjë. Ata argumentuan se konstruktet motivuese normalisht

funksionojnë si ndërmjetës për tiparet dhe marrëdhëniet e lidërshiptit ose të performancës organizative. Prandaj, bazuar në hulumtimet e mëparshme që përgjithësisht zbuluan se MTL ka efekte të drejtpërdrejta pozitive në variablat e lidërshiptit mbi dhe përtej parashikuesve të tjerë të lidërshiptit, ky artikull hipotezoi MTL si një ndërmjetës për shoqërimin e personalitetit dhe sjelljes së lidërshiptit. Për më tepër, sipas Hendricks dhe Payne të cilët gjetën rezultate paksa të papajtueshme me kërkimet tjera sugjerohet që me MTL të eksperimentohet edhe më tej.

- **Autonomia e punës, tiparet e lidërshiptit, sjellja e lidërshiptit dhe performanca e xhamisë**

Kishte studiues dhe zyrtarë qeveritarë që argumentuan se imamëve në Malajzi duhet t'u jepet autonomi më e lartë. Sipas shumicës së studiuesve të lidërshiptit dhe organizatës, variablat e situatës funksionojnë si moderatorë në sjelljen organizative si dhe në kërkimet e lidërshiptit organizativ. Ky artikull argumenton se situata autonome e intenzitetit të punës mund të normalizojë lidhjen e tipareve të lidërshiptit, sjelljen e lidërshiptit të imamëve dhe performancën e xhamisë. Për më tepër, ky artikull argumenton gjithashtu se niveli i autonomisë në punën e imamëve mund të ndikojë në performancën e tyre veçanërisht në aspektin e organizimit të programeve dhe kështu mund të ndikojë në shkallën e frekuentimit të xhamive në Malajzi. Ky

argument është në përputhje me teorinë e rrugës dhe qëllimit të efektivitetit të lidërshiptit dhe teorinë që shpjegon fenomenin e autonomisë së punës që prek personelin dhe rezultatet e punës nga Turner dhe Lawrence. Kjo është për shkak se, nga njëra anë, teoria e rrugës dhe qëllimit të efektivitetit të lidërshiptit shpjegon dy aspekte në proceset e lidërshiptit, natyrën e detyrave dhe natyrën e ndjekësve, ndërsa autonomia e punës mund të përfshihet në kategorinë e natyrës së detyrave të liderëve. Nga ana tjetër, teoria e shpjeguar nga Turner dhe Lawrence në vitin 1965 dhe Hackman dhe Lawler në vitin 1971, autonomia e detajuar e punës mund të ndikojë në një nga tre gjendjet kritike psikologjike, ose të përjetojë përgjegjësi për rezultatet e punës. Dy gjendjet e tjera kritike psikologjike për punëtorët janë kuptimi i përjetuar i punës dhe njohja e rezultateve aktuale të aktiviteteve të punës. Në përgjithësi, këto tre gjendje kritike psikologjike mund të ndikojnë në rezultatet personale dhe të punës së individit. Në përgjithësi, këto tre gjendje kritike psikologjike mund të ndikojnë në rezultatet personale dhe të punës së individit. Bazuar në këto dy teori, përfshirja e autonomisë së punës si një ndryshore e moderuar për tiparet dhe sjelljen e imamëve, si dhe qasjen udhëheqëse të tyre dhe performancën e xhamisë duhet të arsyetohet.




FIGURA1

Bazuar në analizën e mësipërme mbi teoritë dhe kërkimet e ndërlidhura, ky artikull argumenton se mund të prezantohet një model i udhëheqjes së imamëve dhe performancës së xhamisë. Figura 1 përmbledh detajet e modelit më tej.

- KONKLUZION

Në përgjithësi, ky artikull argumenton se çështja e performancës së xhamive në Malajzi duhet të hetohet edhe nga këndvështrimi i teorive dhe praktikave të udhëheqjes organizative. Modeli i paraqitur në figurën 1 më sipër sugjeron se ka një ndikim të drejtpërdrejtë të imamëve, si udhëheqës të xhamisë, në performancën e xhamisë. Megjithatë, me qëllim që të sigurohet që lidhja e udhëheqjes së imamëve dhe performanca e xhamisë mund të funksionalizohet më mirë, ky artikull propozon që tiparet e imamëve të funksionojnë si elementet më themelore për t'u mundësuar imamëve të performojnë si udhëheqës efektivë të xhamisë. Në mënyrë të veçantë, figura 1 deklaroi se tiparet e lidershipit të imamëve mund të ndikojnë në performancën e xhamisë përmes sjelljeve të tyre udhëheqëse. Për më tepër, duke u bazuar në të kuptuarit se situata dhe rezultatet e lidershipit janë të lidhura, modeli argumenton se disa variabla të situatës dhe në këtë artikull, autonomia e punës specifike, mund të jenë një moderator domethënës për tiparet e lidershipit të imamëve, sjelljen dhe performancën e xhamisë. Për më tepër, bazuar në të kuptuarit se situata dhe rezultatet e lidershipit janë të lidhura, modeli argumenton se disa variabla të situatës dhe në këtë artikull, autonomia funksionale, mund të jenë një ndërmjetës i rëndësishëm i tipareve të udhëheqjes së imamëve, sjelljes së tyre dhe korrelacioneve të performancës së xhamisë. Në mënyrë të përmblodhur, nga kjo analizë pritet që çështja e performancës së xhamisë dhe udhëheqjes së imamëve mund të kuptohen më

tej duke e çuar çështjen për t'u hetuar në mënyrë empirike nga këndvështrime të ndryshme, ndërsa specifikisht në këtë artikull këndvështrimi i udhëheqjes organizative.

Përktheu:

Nisma për zhvillimin e predikuesve – thirrësve | Thirrja.org